



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
**MINISTRIA E INTEGRIMIT
EUROPIAN**

Ministrja e Integrimit European, znj. Klajda Gjoshja, pret z. Eduard Auer, Shef i Divizionit për Ballkanin Perëndimor, EEAS.

2017-04-06 12:16:00



Ministrja e Integrimit European, znj. Klajda Gjoshja, priti në një takim z. Eduard Auer, Shef i Divizionit për Ballkanin Perëndimor, EEAS.

Ministrja Gjoshja: Zgjedhjet bëhen për qytetarët, politika duhet të japë garanci për ta

“Zgjedhjet e lira, kriter për integrimin e vendit”

Ministrja e Integrimit European, znj. Klajda Gjoshja, priti në një takim z. Eduard Auer, Shef i Divizionit për Ballkanin Perëndimor, EEAS.

Në fokus të këtij takimi, ishte situata politike në vend. Ministrja Gjoshja theksoi se dialogu mes palëve, është i domosdoshëm për t'i dhënë zgjidhje kësaj situatë.

“Zgjedhjet të cilat ne i kemi dhe një kriter shumë të rëndësishëm për procesin e integrit, janë një e drejtë legjitime dhe bëhen për qytetarët. Klasës politike i takon të japë garanci për këto zgjedhje”, tha Ministrja Gjoshja.

Duke u ndalur tek reforma në drejtësi si kusht për hapjen e negociatave, bashkëbiseduesit theksuan se zgjidhja e ngërçit politik do t'i hapte gjithashtu rrugën zbatimit shpejtë të kësaj reforme, veçanërisht ligjit të vettingut.